

VENDIM
Nr.191, datë 19.2.2009

PËR DHËNIEN E NJË FONDI FINANCIAR KOMUNËS HAJMEL, TË QARKUT TË SHKODRËS, PËR TË NDIHMUAR FAMILJET E DËMTUARA, PËR SHKAK TË PËRMBYTJES NGA LUMI GJADËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 31 e 32/a të ligjit nr.8756, datë 26.2.2001 “Për emergjencat civile”, e të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Hajmel, të qarkut të Shkodrës, në buxhetin e vitit 2009, t’i shtohet fondi 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për të ndihmuar familjet e dëmtuara, për shkak të përmbytjes nga lumi Gjadër.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Fondi i dhënë sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përdoret nga familjet, për të riparuar dëmtimet e shkaktuara nga përmbytja.
4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut të Shkodrës dhe komuna Hajmel për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha